



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

DEPARTAMENTI PËR FAMILJET E DËSHMORËVE, INVALIDET E LUFTËS
DHE VIKTIMAT CIVILE

Në përputhje më nenin 5 paragrafi 5.4 (b), (c) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës.

Duke pasur parasysh nenin 8 dhe 12 të Ligjit për Statusin dhe të drejtat e familjeve të Dëshmoreve, invalidëve, veteraneve dhe pjesëtareve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës,

Me qëllim të vlerësimit dhe verifikimit të mirëfilltë të gjendjes shëndetësore të të gjithë invalidëve të luftës se UÇK-së dhe atyre civil,

Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 08/2006
PËR
PUNËN E KOMISIONIT MJEKSOR LIDHUR ME VLERSIMIN DHE
CAKTIMIN E SHKALLES SE INVALIDITETIT TË INVALIDEVE TË LUFTËS
SE UÇK-së DHE ATYRE CIVIL

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ në mënyrë unike, rregullohet puna e Komisioneve mjekësore (angazhimi i eksperteve mjekësore, procedurat e shqyrtimit të lëndëve, orari i punës, detyrat dhe përgjegjësitë, kompensimi financiar) të cilat do të punojnë dhe veprojnë në kuadër të Departamentit të familjeve të dëshmoreve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile, në tekstin vijues (DFDIL) pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për vlerësimin dhe caktimin e shkalles se invaliditetit të Invalidëve të luftës se UÇK-së dhe atyre civil.

Neni 2

Formimi i komisioneve mjekësore

- (1) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ,përkatësisht Departamenti i familjeve të dëshmorëve,invalidëve të luftës dhe viktimave civile më qëllim të zbatimit sa më efikas dhe të drejtë të dispozitave ligjore nga neni 8,12 dhe 14 të Ligjit për vlerat e luftës, formon komisione mjekësore për vlerësimin dhe caktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të luftës se UÇK-së dhe atyre civil.
- (2) Komisionet mjekësore dhe DFDIL i MPMS-së, do të jenë përgjegjës për administrimin e kontrollimeve mjekësore përkitazi me vlerësimin dhe caktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të luftës dhe atyre civil, në përputhje me dispozitat e Ligjit për vlerat e luftës .

Neni 3

Përbërja e komisioneve mjekësorë

- (1) Komisionet Mjekësore formohen prej specialistëve të kualifikuar dhe të dëshmuar të fushës mjekësore të punës, ortopedisë ,kirurgjisë,neuropsikiatrisë e tjera, varësisht nga nevojat që paraqiten për vlerësim mjekësor sipas dokumentacionit medicinal që kanë dorëzuar palët për shqyrtim.
- (2) Me rastin e angazhimit të ekspertëve mjekësor në Komisionet mjekësore të DFDIL të MPMS-së duhet të përfillen me përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MSHP/DASHC Nr. 2003/09 për orët e punës.

Neni 4

Procedurat për funksionimin e komisioneve mjekësore

- (1) MPMS – DFDIL përmes këtij Udhëzimi Administrativ themelon dy komisione Mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë, me qëllim të vlerësimit mjekësor të aftësisë dhe caktimit të shkallës së invaliditetit të invalidëve të Luftës se UÇK-së dhe atyre civil.
- (2) Kryetari i Komisionit Mjekësor (Nëpunës nga DFDIL) është përgjegjës për listën e anëtarëve të komisionit,organizimin e kontrollimeve specialitike dhe mbajtjen e seancave të komisionit në mënyrë efektive dhe me kohë, në mënyrë që të procedohen aplikacionet me kohë, për ti mundësuar autoritetit të caktuar kohë të mjaftueshme për të marrë vendime përkatëse.

- (3) Të gjithë anëtarëve të komisionit para fillimit të punës në cilësinë e anëtarit u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë për metodat e punës në mënyrë që të sigurohet ndarje efektive e detyrave të anëtarëve të komisionit mjekësor. Të gjitha deklaratat e tilla mbahen nga një zyrtar i DFDIL i autorizuar nga Drejtori i këtij Departamenti .
- (4) Procedurat për konsultime të Komisionit Mjekësor me specialistët shtesë duhet të jenë në pajtim me Procedurat e Administrimit Mjekësor (PP PAM 001) dhe marrëveshjet relevante me Ministrinë e Shëndetësisë.
- (5) DFDIL i MPMS-së do të mbaj të dhënat për të gjithë mjekët e licencuar në Kosovë, në pajtim me marrëveshjet relevante me Ministrinë e Shëndetësisë, kryesisht për zbatimin e masave kontrolluese për mjekët që lëshojnë certifikatën e mjekut,dhe për masa kontrolluese ndaj anëtarëve të komisionit mjekësor dhe të çdo specialisti me të cilin komisioni mjekësor këshillohet.
- (6) DFDIL i MPMS-së do të mbaj dhe administroj një sistem për kalkulimin e të dhënave të regjistruara nga vlerësimet mjekësore të Komisionit Mjekësor për secilin aplikues . Rezultatet e fituara në këtë mënyrë do të shfrytëzohen për përzgjedhshmërinë mjekësore për pensione dhe benificione sipas skemës. Në sistemin e kalkulimit të rezultateve të vlerësimeve mjekësore mund të kenë qasje vetëm nëpunësit e caktuar dhe të përzgjedhur nga drejtori i DFDIL-së. Sistemi i kalkulimit duhet të konsiderohet si informatë sekrete dhe publikimi i paautorizuar i sistemit të kalkulimit apo qasja e paautorizuar në këtë sistem nuk lejohet.

Neni 5

Kompensimi Financiar

- (1) Ekspertët mjekësor të angazhuar në komisionet mjekësore të Departamentit të DFDIL-së me orar të plotë të punës dhe gjysmë orar të punës do të kompensohen në përputhje me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës .
- (2) Komisionin mjekësor e udhëheq Kryetari i Komisionit që caktohet nga DFDIL.
- (3) Ekspertët mjekësor të angazhuar në komisionet mjekësore të DFDIL-së kohë pas kohe me orar fleksibil të punës, për pjesëmarrje në seancë ditore do të kompensohen nga 30 euro për seancë.
- (4) Komisionet mjekësore në çdo seancë duhet të shqyrtojnë së paku 25 lëndë .
- (5) Punëtorët e DFDIL-së të angazhuar në komisionet mjekësore pas orarit të punës dhe ditëve jo të punës kompensohen nga 25 euro për seancë ditore.

Neni 6

Shqyrtimi i Dokumentacionit

- (1) Aplikacionet e pranuar për pensionin invalidor personal se bashku me dokumentacionin tjetër mjekësor, të arkivuara dhe sistemuara, në përputhje me rregullat e administratës, para Komisionit mjekësor i paraqet nëpunësi administrativ i divizionit përgjegjës të DFDIL.
- (2) Komisioni mjekësor pas shqyrtimit të dokumentacionit medicinal dhe shiqimit të palës sipas nevojës, e nxjerr vlerësimin përkatës të shkallës së invaliditetit, më q' rast do të lëshoj një vërtetim më shkrim për nivelin e paaftësisë dhe shkallës së invaliditetit.
- (3) Konstatimi i nxjerr nga komisioni mjekësor nënshkruhet nga të gjithë mjekët që marrin pjesë në seancë si dhe nga zyrtari administrativ i DFDIL-së pranë emrave të tyre të shkruara në shkronja shtypi.
- (4) Pas nxjerrjes së konstatimit nga komisioni mjekësor zyrtari administrativ lëndët e shqyrtuara ja dërgon sektorit përkatës për procedurë të mëtutjeshme.

Neni 7

Rivlerësimi i kërkesave nga komisioni mjekësor

- (1) Komisioni i shkallës së parë i shqyrton lëndët sipas kërkesave të palëve për herë të parë, dhe kërkesave për rivlerësim pas kalimit të afatit 6 mujor nga data e nxjerrjes së vendimit të fundit sipas kërkesës apo ankesës.
- (2) Komisioni mjekësor i shkallës së dytë i rivlerëson dhe shqyrton lëndët sipas ankesave të ushtruara nga palët ndaj vendimeve të shkallës së parë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

- (1) Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së i cili mund të pëson ndryshime dhe plotësime varësisht nga kërkesat për zbatimin efikas dhe të drejt në praktikë.

Prishtinë, shtator 2006

Sekretari i Përhershëm i MPMS-së

Eshref Shabani